

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

midis

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

dhe

UNIVERSITETIT "S & P QIRIAZI"

Universiteti Bujqësor i Tiranës, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatos HARIZAJ dhe Universiteti "S & P Qiriazhi", i përfaqësuar nga Rektori Prof. i Asoc. Stefan Qirici, për efekt të kësaj marrëveshje më poshtë referohen si palë:

- Duke shprehur vullnetin e përbashkët për të vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor
- Duke patur parasysh rolin e pazëvendësueshëm të institucioneve akademike shkencore në zhvillimin dhe prosperitetin e vendit

bien dakord të nënshkruajnë marrëveshjen si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshje është të institucionalizojë bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve në nivele të ndryshme.

Neni 2

Për funksionimin efektiv të këtij bashkëpunimi, të dy palët do të respektojnë dhe zbatojnë të gjitha procedurat si dhe do të shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat e nevojshëm të bashkëpunimit.

Neni 3

Marrëveshja i hap rrugën strukturave përbërëse të dy palëve të hartojnë programe dypalëshe më të detajuara për të bashkëpunuar në fushat kërkimore-shkencore mbi bazën e mirëkuptimit dhe përfitimit të ndërsjelltë.

Neni 4

Palët angazhohen, që për nevoja të procesit mësimor të organizojnë shkëmbime të stafit akademik me kusht që kjo të mos sjellë vështirësi për vijueshmërinë normale të këtij procesi në institucionin e origjinës.

Neni 5

Palët angazhohen, që në periudha të caktuara të organizojnë simpoziume shkencore të përbashkëta me arritjet më të mira duke parë me përparësi temat e përbashkëta.

Neni 6

Palët mirëkuptohen për organizimin e seminareve të përbashkëta me studentët dhe stafin akademik në formën e shkëmbimit të ideve.

Neni 7

Në çdo fund viti, hartohet një raport i përbashkët për ecurinë e këtij bashkëpunimi, ku analizohen arritjet, mangesitë dhe ecuria për të ardhmen.

Neni 8

Marrëveshja është në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 9

Ndryshimet, përmirësimet ose anulimi i kësaj Marrëveshje bëhet me pëlqimin e të dy palëve, duke njoftuar paraprakisht me shkrim jo më pak se 6-muaj para.

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Prof. Dr. Fatos HARIZAJ

Rektor

Datë _____



UNIVERSITETI "S & P Qiriazi"

Prof. i Asoc. Stefan QIRICI

Rektor

Datë _____

